

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 453 Prot.

Tiranë, më 26.04 2016

VENDIM Nr. 28, datë 22.04.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.5 të datës 22.04.2016, pasi shqyrtoi *Relacionin mbi dokumentimin e gjetjeve të konstatuara gjatë punës për restaurimin e "Tyrbes së Kapllan Pashës", Tiranë*, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Relacionin mbi dokumentimin e gjetjeve të konstatuara gjatë punës për restaurimin e "Tyrbes së Kapllan Pashës", Tiranë*, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Instituti i Arkeologjisë, sipas përcaktimeve të mëposhtme.
2. Elementët arkitektonikë të dokumentuar, të depozitohen pranë DRKK Durrës (Sektori i Kulturës Kombëtare, Tiranë) pasi të paktën tre prej tyre (dy elementë harku dhe një bllok pilastrri -nervure të pjesës ortogonale) i përkasin një Tyrbeje tjetër, që sot nuk ekziston.
3. Pas dokumentimit të dy strukturave të tjera, të konstatuara gjatë pastrimit të sipërfaqes përreth monumentit (Strukturës Nr. 1-varrit dhe Strukturës së dytë- një fragment muri i ndërtuar me gurë lumi të lidhur me njeri-tjetrin me llaç dhe që ndodhet paralel me strukturën Nr. 1-varrin, ngjitur me të), shoqëria e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k të kryejë konservimin e tyre, nëpërmjet mbulimit in situ dhe në vijim të marrë masat për rehabilitimin e zonës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO